



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 257, Datë 21.10.2025

MBI

**MIRATIMIN E PROCESVERBALEVE TË MBLEDHJEVE TË BORDIT TË ERE-S NR.
40 DATË 14.10.2025 DHE NR. 41 DATË 15.10.2025**

Në mbështetje të neneve 13 dhe 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe të nenit 5, pika 4, të Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 144, datë 30.09.2019, i ndryshuar me vendimin nr. 205, datë 30.09.2024; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e datës 21.10.2025, pasi u njoh me përmbajtjen e procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më datë 14.10.2025 dhe 15.10.2025, të përgatitura nga Sekretaria e Bordit,

Vendosi:

1. Miratimin e procesverbaleve të Mbledhjeve të bordit të ERE-s, nr. 40 datë 14.10.2025 dhe nr. 41 datë 15.10.2025. (Procesverbalet bashkëlidhur).
2. Procesverbalet e miratuara sipas pikës 1 të këtij vendimi nënshkruhen nga Kryetari dhe Sekretari i Bordit.
3. Ngarkohet për arkivimin e këtij vendimi dhe procesverbalit Sekretaria e Bordit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.